FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.172 21 dhjetor 2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9837 datë 3.12.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", të ndryshuar.....	5273
Vendim i Kuvendit nr.148, datë 10.12.2007	Për ngritjen e nënkomisionit "Për të drejtat e njeriut"……	5274
Vendim i Kuvendit nr.150, datë 17.12.2007	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr.101, datë 17.5.2007 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore", të ndryshuar.....	5274
Vendim i Kuvendit nr.151, datë 17.12.2007	Për emërimin e një anëtari në Bordin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike.....	5275
Vendim i KM nr.857, datë 29.11.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës "Transballkanike", Vlorë.....	5275
Vendim i KM nr.869, datë 19.12.2007	Për dhënie asistence ekonomike të menjëhershme personave, që përfitojnë pension ……	5280
Udhëzim i METE nr.965, datë 11.12.2007	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore"……	5281
Vendim i ERE nr.69, datë 12.12 .2007	Për shqyrtimin e transferimit të licencës nga shoqëria "HCA" sh.p.k. te shoqëria "Balkan Green Energy" sh.p.k.....	5285

Vendim i ERE nr.70, datë 10.12.2007	Për shqyrtimin e transferimit të licencës nga shoqëria "Essegei Shqipëri Smokthina" sh.p.k. te shoqëria "Albanian Green Energy" sh.p.k.....	5286
Vendim i ERE nr.71, datë 12.12.2007	Për miratimin e fillimit të procedurave për transferimin e aseteve nga shoqëria "KESH" sh.a. te shoqëria "OSSH" sh.a…….	5286
Vendim i ERE nr.72, datë 12.12.2007	Për miratimin e fillimit të procedurave për licencim në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike shoqërisë "OSSH" sh.a……	5287
Vendim i ERE nr.73, datë 12.12.2007	Për miratimin e fillimit të procedurave për licencim në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike shoqërisë "OSSH" sh.a.....	5287
Vendim i ERE nr.74, datë 12.12.2007	Për miratimin e fillimit të procedurave për licencim në aktivitetin e importit të energjisë elektrike shoqërisë "OSSH" sh.a.....	5288
Vendim i ERE nr.75, datë 12.12.2007	Për kualifikimin e impiantit prodhues HEC i Kalivacit, si burim i rinovueshëm energjie……	5288
Vendim i ERE nr.76, datë 14.12.2007	Për refuzimin e dhënies së licencës në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike, shoqërisë "CERS" sh.p.k.....	5289
Vendim i ERE nr.77, datë 14.12.2007	Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike nga konsumatorët jofamiljarë, për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar.....	5289
Vendim i ERE nr.78, datë 14.12.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.64, datë 27.11.2007 të Bordit të Komisionerëve "Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike"..……	5290
Vendim i KNSH nr.22, datë 12.12.2007	Për skemën ekzistuese të përjashtimit të operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH.....	5290
Vendim i KNSH nr.23, datë 12.12.2007	Për miratimin e udhëzimit "Për disa kategori të ndihmave horizontale".....	5291
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Evangjellos Bineri.....	5301
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Seide Kondi ……..	5301
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Elton Çeliku.....	5301

LIGJ
Nr.9837, datë 3.12.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8093, DATË 21.3.1996 "PËR REZERVAT UJORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 61 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në paragrafin e dytë bëhen këto ndryshime:

a) fjalia e parë riformulohet si më poshtë:

"Për shkeljet e parashikuara në nenet 14 pika 1 shkronja "ë", 24 paragrafi i parë dhe i dytë, 47, 48, 49 dhe 50 të këtij ligji, kundërvajtësi dënohet nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në varësi të shkallës së shkeljes, me:";

b) shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) gjobë 500 000 lekë;";

c) shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) pezullim të veprimtarisë deri në 10 ditë, në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e rezervave ujore;".

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

"Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar paraqet kërkesën për heqjen e licencës profesionale, personale e të shoqërisë pranë organit përkatës, në rast të ndërtimit pa leje, të shfrytëzimit të kundërligjshëm të inerteve, si dhe të lejes së veprimtarisë përkatëse të shoqërive, që shkelin dispozitat e mësipërme, kur vërejnë shkelje të kushteve teknike të zbatimit apo projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit.".

3. Paragrafi i katërt shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 69 bëhen këto ndryshime:

a) në paragrafin e parë dhe të tretë fjalët "Drejtorit të Policisë së Ndërtimit zëvendësohen me fjalët "Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar";

b) në paragrafin e dytë, të pestë dhe të shtatë, fjalët "organit/eve/et të Policisë së Ndërtimit" zëvendësohen me fjalët "Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar";

c) paragrafi i gjashtë ndryshohet si më poshtë:

"Gjoba, si dhe shpenzimet, që përballohen nga autoriteti i ujit dhe nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, paguhen nga kundërvajtësit brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të tyre ose nga data kur ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës.";

ç) në paragrafin e tetë fjalët "Policia e Ndërtimit" zëvendësohen me fjalët "Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5544, datë 13.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

VENDIM

Nr.148, datë 10.12.2007

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT "PËR TË DREJTAT E NJERIUT"

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni "Për të drejtat e njeriut", në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

1. Arenca Trashani	Kryetare
2. Ndre Legisi	Zëvendëskryetar
3. Spiro Peçi	anëtar
4. Eris Hoxha	"
5. Parid Teferiçi	"
6. Besnik Dervishi	"
7. Blendi Klosi	"

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

VENDIM
Nr.150, datë 17.12.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.101, DATË 17.5.2007 "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN ZGJEDHORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Pika VII e vendimit ndryshohet si më poshtë:

"VII. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore shtyhet për një periudhë prej 3 muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi, 17.12.2007".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.151, datë 17.12.2007

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI NË BORDIN E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006, si dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Ardian Haci emërohet anëtar i Bordit të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike për një periudhë 5-vjeçare, në vend të zonjës Entela Çipa, së cilës i ka mbaruar mandati.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.857, datë 29.11.2007

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS "TRANSBALLKANIKE", VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës "Transballkanike", Vlorë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 13 013.8 m^2 tokë truall, të vlerësuar me çmimet 9 944.14 lekë/m^2, me vlerë 129 410 552 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e katërqind e dhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë, për objekte, me sipërfaqe të përgjithshme 3 879.4 m^2, të vlerësuara me çmimin 42 000 lekë/ m^2, me vlerë 162 934 800 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 290 209 415.5 (dyqind e nëntëdhjetë milionë e dyqind e nëntë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë pikë pesë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 455 000 (katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 290 209 415.5 (dyqind e nëntëdhjetë milionë e dyqind e nëntë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 1.12.2007 dhe të përfundojë më 30.12.2007.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim nga ZRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Të gjithë pronarët, të cilët kanë dorëzuar paraprakisht dokumentacionin e pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, në çastin e likuidimit duhet të dorëzojnë kartelën e pronësisë, brenda afateve ligjore të vlefshmërisë së saj. Të gjithë pronarët, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit dhe pasi të kenë paraqitur më pas dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Rrethi Vlore
Bashkia Vlore

LISTA E PRONARëVE Të PASURIVE Të PALUAJTSHME PRONë PRIVATE Që PREKEN SI REZULTAT I RRUGëS "TRANSBALLKANIKE"

Lloji I Pasurise Patundshme: Truall dhe objekte nr.(1-49)

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr.Parc	Z.Kadastrale	TRUALL			Objekte			Vlera totale ne leke	Shenime
						Sip. (m2)	Cmimi L/m2	Vlefta ne leke	Sip. (m2)	Cmimi L/m2	Vlefta ne leke		
1	Lefter		Lamce	4/208	8604	670	9944.14	6662573.8				6662573.8	Konfirmim nga ZRRPP
2	**Trashëgimatrët**		**Lamce**	**4/202**	**8604**	**260**	9944.14	2585476.4				449540	Konfirmim nga ZRRPP
3	Gezim		Shaqiraj	18/139, 18/132	8604	638	9944.14	6344361.32	**79**	42000	3318000	9662361.32	Konfirmim nga ZRRPP
4	Trashegimtaret		Stefani	29/57	8603	79	9944.14	785587.06				785587.06	Konfirmim nga ZRRPP
5	Nuri		Dino	20/93	8603	116	9944.14	1153520.24	62.2	42000	2612400	3765920.24	Konfirmim nga ZRRPP
6	**Spiro**		**Karpuzi**	**18/131,18/140**	**8604**	**537**	9944.14	**5340003.18**	**79**	42000	3318000	8658003.18	Konfirmim nga ZRRPP
7	Kamber Aferdita		Dervishaj	29/49	8604	60	9944.14	596648.4	98	42000	4116000	4712648.4	Konfirmim nga ZRRPP
8	Bardhyl		Lilaj	39/136	8605	**190**	9944.14	1889386.6				1889386.6	Konfirmim nga ZRRPP
9	Guri		Kamberi	29/383	8603	150	9944.14	1491621	68	42000	2856000	4347621	Konfirmim nga ZRRPP
10	Lavderim		Muka		8605		9944.14		132	42000	5544000	5544000	Konfirmim nga ZRRPP
11	Llambi		Mitre	29/33	8605	176	9944.14	1750168.64				1750168.64	Konfirmim nga ZRRPP
12	Sotiraq		Mitre	29/34	8605	330	9944.14	3281566.2				3281566.2	Konfirmim nga ZRRPP
13	Haxhi		Alliraj	5/46	8604		9944.14		123	42000	5166000	5166000	Konfirmim nga ZRRPP
14	Astrit		Alimerko	**4/180**	8603		9944.14		50	42000	2100000	2100000	Konfirmim nga ZRRPP
15	Taip		Feta	29/386	8603	80	9944.14	795531.2				795531.2	Konfirmim nga ZRRPP
16	Agim	Vesel	Arifi	24/149	8603	80	9944.14	795531.2				795531.2	Konfirmim nga ZRRPP
17	**Trashegimtaret**		**Muco**	35/80	8604	532	9944.14	5290282.48	**196**	42000	8232000	13522282.48	**Konfirmim nga ZRRPP**
18	Feim		Rizai	u	8604	50	9944.14	497207	50	42000	2100000	2597207	Konfirmim nga ZRRPP
19	Engjell		Sadiraj	35/78	8604	365	9944.14	3629611.1	96	42000	4032000	7661611.1	Konfirmim nga ZRRPP
20	**Agim**	**Shaqir**	**Koburja**	**39/15**	8605	**214**	9944.14	2128045.96	**22**	42000	924000	3052045.96	Konfirmim nga ZRRPP
21	Shaze		Lazaj	18/130	8604	**188**	9944.14	1869498.32				1869498.32	Konfirmim nga ZRRPP
22	**Familja**		**Kona**	**35/68**	**8604**	**117**	9944.14	**1163464.38**	**105**	**42000**	**4410000**	**5573464.38**	Konfirmim nga ZRRPP

23	Agron		Haxhiraj		8605	938	9944.14	9327603.32				9327603.32	Konfirmim nga ZRRPP
24	Xhyher		Xhyheri	45/222,50/23	8605	350	9944.14	3480449				3480449	Konfirmim nga ZRRPP
25	Flora		Cekodhima	5/46	8604	51	9944.14	507151.14	31	42000	1302000	1809151.14	Konfirmim nga ZRRPP
26	Lili		Golemi	121	8604	63	9944.14	626480.82				626480.82	Konfirmim nga ZRRPP
27	Trashegimtaret		Skendaj	18/3	8603	204	9944.14	2028604.56	290	42000	12180000	14208604.56	Konfirmim nga ZRRPP
28	Piro Rajmonda		Kondi Aliaj		8605		9944.14		22	42000	924000	924000	Konfirmim nga ZRRPP
29	Ahmet		Sjerifaj		8605		9944.14		20	42000	840000	840000	Konfirmim nga ZRRPP
30	Malo		Resulaj	29/418	8603	45	9944.14	447486.3	240	42000	10080000	10527486.3	Konfirmim nga ZRRPP
31	**Theofan**		**Meci**		**8603**	**154**	9944.14	**1531397.56**	**234**	**42000**	**9828000**	**11359397.56**	**Proçes regjistrimi**
32	**Filip**		**Meci**		**8603**	**154**	9944.14	**1531397.56**	**36**	**42000**	**1512000**	**3043397.56**	**Proçes regjistrimi**
33	Zija		Cifciu	4/77	8604	319	9944.14	3172180.66	54	42000	2268000	5440180.66	Konfirmim nga ZRRPP
34	Jorgji		Vidhaj	4/120	8604	193	9944.14	1919219.02	91.5	42000	3843000	5762219.02	Konfirmim nga ZRRPP
35	Artan		Zemani		8604	213	9944.14	2118101.82	105	42000	4410000	6528101.82	Konfirmim nga ZRRPP
36	Qemal		Tringa		8604	300	9944.14	2983242				2983242	Konfirmim nga ZRRPP
37	Idai		Shehu	2575	8605	312	9944.14	3102571.68	91.3	42000	3834600	6937171.68	Konfirmim nga ZRRPP
38	**Vasil**		**Leka**	**30/56**	**8605**	**340**	9944.14	**3381007.6**	**540**	**42000**	**22680000**	26061007.6	Konfirmim nga ZRRPP
39	Bashkim		Rodha	36/36	8605	165	9944.14	1640783.1	77	42000	3234000	4874783.1	Konfirmim nga ZRRPP
40	Sulejman		Tahiri		8604	42	9944.14	417653.88				417653.88	Konfirmim nga ZRRPP
41	Agim Ylli Luiza Dilaver		Kalemaj		8603	161	9944.14	1601006.54	74.6	42000	3133200	4734206.54	Konfirmim nga ZRRPP
42	Sotir		Bezhani	**5/2,5103**	8604	389	9944.14	3868270.46	**208**	42000	8736000	12604270.46	Konfirmim nga ZRRPP
43	Bajram		Saliu	27/200	8604	515	9944.14	5121232.1	108.8	42000	4569600	9690832.1	Konfirmim nga ZRRPP
44	Veiz		Shahu	4/122	8604	300	9944.14	2983242	77	42000	3234000	6217242	Konfirmim nga ZRRPP
45	Kristaq		Komini		8605	84	9944.14	835307.76				835307.76	Konfirmim nga ZRRPP
46	Sulejman	Muhamet	Shehi	18/87	8604	66	9944.14	656313.24				656313.24	Konfirmim nga ZRRPP
47	Evis	Sulejman	Shehi	18/50	8604	495	9944.14	4922349.3				4922349.3	Konfirmim nga ZRRPP
48	**Shpëtim**		**Sharra**	**4/167, 5/100**	**8604**	**1340**	9944.14	13325147.6				13325147.6	**Konfirmim nga ZRRPP**
49	**Adem Haxhi**		**Nexhipi Nexhipi**		**8604**	270.75	9944.14 9944.14	2692375.905	**121**	42000	5082000	7774375.905	**Konfirmim nga ZRRPP**
50	**Festime**		**Troqe**	**18/111**	**8604**	**181.25**	9944.14	1802375.375				1802375.375	**Konfirmim nga ZRRPP**
51	**Demir**		**Alliko**	**5/35**	**8604**	**64**	9944.14	636424.96	**48**	42000	2016000	2652424.96	**Proçes regjistrimi**
52	**Diana**		**Agaçi**	**18/112**	**8604**	**181.25**	9944.14	1802375.375				1802375.375	**Konfirmim nga ZRRPP**
53	**Minushe**		**Mërtiri**		**8604**	**275**	9944.14	2734638.5	**155**	42000	6510000	9244638.5	**Proçes regjistrimi**
54	Hekuran		Aliaj	20/115	8603	16.5	9944.14	164078.31	59	42000	2478000	2642078.31	Konfirmim nga ZRRPP

55	Metush	Qamil	Llanaj	36/79	8605				36	42000	1512000	1512000	Konfirmim nga ZRPP
	Shuma					13013.8		129410551.9	3879.4		162934800	290209415.5	

VENDIM
Nr.869, datë 19.12.2007

PËR DHËNIE ASISTENCE EKONOMIKE TË MENJËHERSHME PERSONAVE, QË PËRFITOJNË PENSION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "ç" të nenit 66 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë asistencë ekonomike të menjëhershme, në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë:

a)personat, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) personat, që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që trajtohen me shpërblim mujor, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", personat, që marrin pension për merita të veçanta, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe personat, që marrin pension të posaçëm shtetëror, të cilët nuk përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti apo familjar;

ç) personat, që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, si dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përllogariten në shumën 2 711 970 000 (dy miliardë e shtatëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe të përdoren, përkatësisht:

a) 2 683 370 000 (dy miliardë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, për asistencën e menjëhershme të pensionistëve;

b) 28 600 000 (njëzet e tetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, për mbulimin e komisioneve të shërbimit të pagesave dhe për shpenzimet administrative.

3. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, në programin "Mbrojtja sociale", t'i shtohet fondi 2 600 000 000 (dy miliardë e gjashtëqind milionë) lekë, ndërsa shuma 111 970 000 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë të përballohet nga transferta e Buxhetit të Shtetit, për sigurimet shoqërore.

4. Procedurat e pagesës së asistencës së menjëhershme për pensionistët të realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, ministritë e linjës dhe të gjitha institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.965, datë 11.12.2007

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE"

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007 "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore", Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZON:

I. Transferimi i aksioneve dhe mbledhja e parë e asamblesë

1. Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.09.2007 Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nxjerr urdhrin për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve te njësitë e qeverisjes vendore.

2. Urdhri do të përmbajë të gjitha ndryshimet në aktet e themelimit të këtyre shoqërive.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës kryen procedurën e depozitimit të këtij urdhri në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me aktet e themelimit të ndryshuara të shoqërisë.

4. Rendi i ditës për zhvillimin e mbledhjes së asamblesë do të përcaktohet nga drejtori i shoqërisë për probleme të cilat nuk janë kompetencë e Këshillit Mbikëqyrës. Drejtori i shoqërisë do t'i njoftojë aksionarët 15 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes dhe do t'u vërë në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes. Në mbledhjen e parë të asamblesë së aksionarëve do të marrë pjesë një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (anëtari i METE-s në Këshillin Mbikëqyrës të kësaj shoqërie). I gjithë dokumentacioni i mbledhjes do t'i vihet në dispozicion aksionarëve të shoqërisë 15 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes, duke i përcaktuar mënyrën e përfaqësimit të tyre në mbledhje (aktin e përfaqësimit). Qëndrimi që do të mbajë përfaqësuesi i aksionarëve në këtë mbledhje do të jetë me shkrim dhe i miratuar nga organi të cilin ai përfaqëson.

II. Procedurat e mbledhjes së asamblesë së aksionarëve të shoqërive

1. Mbledhjet e asamblesë së aksionarëve, e zakonshmja dhe e jashtëzakonshmja, zhvillohen në selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga Këshilli Mbikëqyrës apo Drejtori i Përgjithshëm. Në mungesë ajo mund të thirret, gjithashtu nga: a) eksperti kontabël i autorizuar, b) një mandatmbajtës, i caktuar nga gjyqi, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent ose c) nga likuiduesi, si dhe me kërkesë të aksionarëve që zotërojnë të paktën 10% të aksioneve të shoqërisë.

2. Thirrja e asamblesë së aksionarëve bëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore. Në rast se të gjitha aksionet janë nominative apo në rast se shoqëria ka një aksionar të vetëm, përveç botimeve të parashikuara në paragrafin e mësipërm duhet të dërgohet dhe një njoftim i dërguar me letër rekomande në adresën e çdo aksionari me shpenzimet e shoqërisë.

3. Njoftimi duhet të bjerë në dorën e aksionarëve apo të njihet prej tyre, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë përcakton ditën, orën dhe vendin ku bëhet mbledhja, si dhe natyra e jashtëzakonshme, të zakonshme apo të veçantë të rendit të ditës. Në rast nevoje, ai tregon vendin ku duhet të depozitohen aksionet për prurësin ose certifikata e depozitimit të këtyre aksioneve, për të lejuar të drejtën e pjesëmarrjes në asamble dhe afatin e fundit të këtij depozitimi.

Çdo mbledhje asambleje që thirret në mënyrë të parregullt, mund të anulohet.

Megjithatë veprimi i anulimit nuk pranohet, kur të gjithë aksionarët janë prezentë apo të përfaqësuar.

Mënyra dhe forma e njoftimit të aksionarëve dhe e zhvillimit të mbledhjes së asamblesë është ajo e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar për shoqëritë tregtare.

4. Në thirrjen e mbledhjes së asamblesë duhet të jetë përcaktuar dhe rendi i ditës, i cili përcaktohet nga autori i thirrjes së saj. Megjithatë një apo disa aksionarë që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit, u njihet e drejta për të futur në rendin e ditës disa projektrezoluta. Këto projektrezoluta dërgohen në selitë e

shoqërisë të shoqëruara me shkresë përcjellëse dhe me dokumentin ku vërtetohet zotërimi apo përfaqësimi i pjesës së kapitalit të kërkuar, sipas paragrafit të dytë të këtij neni.

Rendi i ditës i mbledhjes së asamblesë nuk mund të ndryshohet në lajmërimin e dytë.

5. Asambleja e zakonshme merr çdo vendim, përveç atyre që në bazë të ligjit apo këtij statuti duhen marrë nga asambleja e jashtëzakonshme. Asambleja e zakonshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar. Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm në qoftë se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë të paktën 1/2 e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën duhet të marrin pjesë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar, që zotërojnë të paktën 1/4 e aksioneve me të drejtë vote.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicën e votave, që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

6. Vetëm asambleja e jashtëzakonshme ka kompetenca të ndryshojë statutin me të gjitha dispozitat e tij. Çdo klauzolë e kundërt konsiderohet e pavlefshme.

Asambleja e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë të paktën 2/3 e aksioneve dhe në të dytën 1/2 e aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e asamblesë mund të shtyhet për një datë të mëvonshme, jo më larg se dy muaj nga data e thirrjes së parë.

Ajo merr vendim me një shumicë votash prej 4/5 që u përkasin aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

7. Në mbledhjet e aksionarëve përfaqësuesit e bashkive/komunave, paraqiten me autorizimin dhe qëndrimin për rendin e ditës të dhënë nga këshilli komunal/bashkiak. Çdo përfaqësim pa këtë autorizim dhe qëndrimin përkatës të këshillit komunal/bashkiak është i pavlefshëm. Vendimet në asamble merren në bazë të rregullave të përcaktuara në statut dhe në mungesë të përcaktimit të tyre në ligjin për shoqëritë tregtare.

8. Asambleja e aksionarëve drejtohet nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës apo në mungesë të tij nga një person i autorizuar nga kryetari.

Kryetari i asamblesë asistohet nga një sekretar i emëruar nga asambleja e aksionarëve.

Procesverbali i çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë tregon datën dhe vendin e mbledhjes, mënyrën e thirrjes, rendin e ditës, emrat e drejtuesit dhe sekretarit të asamblesë, numrin e aksioneve me të cilat është votuar dhe kuorumi i arritur, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë, një përmbledhje të debateve, tekstin e vendimeve të kaluara për votim dhe rezultatin e votimit. Procesverbali firmoset nga kryetari dhe sekretari i asamblesë dhe duhet noterizuar nga një noter i pranishëm në mbledhjen e asamblesë.

III. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës dhe mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës.

1. Anëtarët e Këshillave Mbikëqyrës zgjidhen në bazë të statutit të shoqërisë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata duhet të kenë:

- të paktën eksperiencë 5-vjeçare pune në degë të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë;

Preferohen profesionet inxhinier, ekonomist, jurist, mundësisht me formim pasuniversitar.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të zgjedhur nga asambleja, mund të shkarkohen në çdo moment nga kjo e fundit për shkaqe të përligjura. Pavarësisht parashikimeve të kësaj pike, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të përcaktuar nga aksionarët që zotërojnë më pak se 1/2 e aksioneve të shoqërisë, nuk mund të shkarkohen pa propozimin e këtyre aksionarëve.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përfitojnë shpërblim për pjesëmarrje në Këshill në bazë të akteve nënligjore në fuqi.

2. Në rastin e vendeve bosh që krijohen nga vdekja apo dorëheqja e një apo disa anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ky Këshill mundet, për periudhën midis dy mbledhjeve të asamblesë, të bëjë emërtime të përkohshme duke pasur parasysh parashikimet e nenit 15 të statutit.

3. Kur numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ka zbritur nën minimumin ligjor, drejtori i përgjithshëm duhet të thërrasë urgjentisht mbledhjen e zakonshme të asamblesë për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

4. Emërimet e bëra nga Këshilli Mbikëqyrës, në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, i nënshtrohen ratifikimit në mbledhjen e radhës së asamblesë së zakonshme. Në mungesë të ratifikimit, shqyrtimet e bëra dhe vendimet e marra më parë nga Këshilli Mbikëqyrës mbeten gjithmonë të vlefshme.

5. Nëse një ose disa vende të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqje të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, zëvendësimi i tyre duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre)

muaj nga koha në të cilën vendi ka mbetur bosh.

6. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.

7. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të emëruar nga asambleja, nuk mund të jenë nga të punësuarit në shoqëri.

8. Asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të bëjë pjesë në më shumë se 2 (dy) këshilla mbikëqyrës të shoqërive anonime që kanë seli në territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në Këshillin Mbikëqyrës dhe mund të jenë të rizgjedhshëm.

10. Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton këtij dhe pagën.

11. Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës drejtohen nga zëvendëskryetari.

12. Këshilli Mbikëqyrës mblidhet jo më vonë se një herë në tre muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë anonime, me thirrjen e kryetarit ose në mungesë të tij të zëvendëskryetarit.

13. Kryetari dhe në mungesë të tij zëvendëskryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, kur drejtori i përgjithshëm ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

14. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkues mund të thërrasin Këshillin duke e përcaktuar rendin e ditës.

15. Në parim, thirrja duhet të bëhet 3 (tre) ditë përpara me letër, telegram, teleks ose telefaks, por thirrja mund të jetë e vlefshme edhe me gojë dhe pa afat, në qoftë se anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e pranojnë atë.

16. Çdo thirrje duhet të tregojë çështjet kryesore të rendit të ditës.

17. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje.

18. Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij.

19. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit është përcaktuese.

20. Këshilli Mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhjen e tij, i cili nënshkruhet nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje.

21. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës evidentohen në procesverbalet e hartuara në parim me dispozitat ligjore në fuqi, nga sekretari i Këshillit Mbikëqyrës.

22. Kopje të këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari (ose në mungesë të zëvendëskryetari) dhe sekretari.

23. Këshilli Mbikëqyrës emëron dhe shkarkon drejtorin e përgjithshëm të shoqërisë me votat e 5 anëtarëve të tij në rast se Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 anëtarë dhe me votat e 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, në rast se numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është i ndryshëm nga 6.

24. Këshilli Mbikëqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga drejtoria dhe i jep kësaj të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga drejtoria pa autorizimin e Këshillit Mbikëqyrës.

25. Me emërimin e drejtorit të përgjithshëm Këshilli Mbikëqyrës lidh kontratë me të për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

IV. Drejtori i përgjithshëm

1. Shoqëria administrohet nga drejtori i përgjithshëm.

2. Drejtori i përgjithshëm ka të drejtë që brenda kompetencave të tij t'u japë një ose disa punonjësve të kompanisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nëndelegimit.

3. Drejtori i Përgjithshëm është person fizik, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Për t'u

zgjedhur drejtor i përgjithshëm, personi duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.400, datë 19.8.1999. Ai mund të zgjidhet edhe jashtë të punësuarve në shoqëri. Nëse një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës emërohet drejtor i përgjithshëm mendati i tij në Këshillin Mbikëqyrës përfundon. Një person nuk mund të emërohet drejtor i përgjithshëm në më shumë se një shoqëri. Ai nuk mund të jetë mbi moshën 65 vjeç.

4. Drejtori i përgjithshëm mund të shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës për shkaqe të përligjura. Drejtori i përgjithshëm emërohet për një periudhë kohe prej katër vjetësh, por mbi baza kontratash të rinovueshme vjetore. Drejtori i përgjithshëm mund të riemërohet.

5. Paga e drejtorit të përgjithshëm caktohet nga Këshilli Mbikëqyrës në aktin e emërimit të tij.

6. Drejtori i përgjithshëm ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë.

7. Në marrëdhëniet me të tretët shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e nënshkruara nga drejtori i përgjithshëm edhe kur këto akte e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i drejtorit të përgjithshëm kapërcen objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe vepronte me keqbesim ose, kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e Statutit nuk është provë e mjaftueshme. Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e drejtorit të përgjithshëm duhet të respektohen nga të tretët.

8. Aktet me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.

9. Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet apo me vlerë mbi 2 (dy) milionë lekë bëhet me autorizim të Këshillit Mbikëqyrës. Në rastet emergjente dhe pamundësie për të mbledhur Këshillin Mbikëqyrës, për kontratat që i kalojnë limitet e mësipërme duhet marrë miratimi me shkrim i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe në mungesë të tij të zëvendëskryetarit. Këta të fundit njoftojnë në mbledhjen e parë të Këshillit Mbikëqyrës, këtë të fundit, për autorizimin e dhënë.

10. Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

11. Drejtori i përgjithshëm bën strukturën e organizimit të shoqërisë të cilën e miraton Këshilli Mbikëqyrës.

V. Miratimi i programeve të zhvillimit të këtyre shoqërive

1. Projektprograme të zhvillimit ekonomik hartojnë të gjitha shoqëritë publike ujësjellës-kanalizime me kapital shtetëror.

2. Hartimi i projektprogrameve të zhvillimit ekonomik të shoqërive bëhet për periudha 12 vjeçare, afatmesme dhe afatgjata, në përputhje me objektivat e caktuara nga organet drejtuese të tyre.

3. Hartimi i projektprogrameve të zhvillimit ekonomik mbështetet në strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik e social, në strategjinë sektoriale dhe aktet ligjore në fuqi. Për hartimin e projektprogrameve kërkesat, afatet dhe mënyra e paraqitjes së treguesve parashtrohen duke respektuar afatet kohore të hartimit të Projektbuxhetit të Shtetit për të njëjtat periudha programimi.

4. Projektprogramet vjetore të zhvillimit ekonomik hartohen nga drejtoria e shoqërisë dhe miratohen nga organet vendimmarrëse të saj, sipas treguesve të kërkuar nga asambleja e aksionarëve si përfaqësuese e pronarit.

5. Drejtoritë e shoqërive ujësjellës-kanalizime për të cilat njësitë e qeverisjes vendore përfaqësojnë pronarin, dërgojnë një kopje të projektprogramit të zhvillimit ekonomik për vitin pasardhës dhe relacion shpjegues, fillimisht në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë brenda datës 30 gusht të çdo viti. Dërgojnë, gjithashtu në këtë afat për mendim një kopje të projektprogramit në ministrinë e linjës administrative, e cila ka kompetencën të monitorojë nevojat për fonde buxhetore në këto shoqëri dhe të programojë miratimin analitik të tyre, në përputhje me mundësitë për financime buxhetore.

6. Mbi bazën e tabelave të projektprogramit të ripunuar dhe relacionit të përgatitur prej drejtorisë së shoqërisë (në të cilat reflektohen sugjerime të mundshme të Ministrisë së linjës administrative), Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë merr vendimin për miratimin e këtij projektprogrami. Vendimi miratues i këshillit mbikëqyrës të shoqërisë duhet të pasqyrojë detyrimisht në shifra nivelet e programuara të treguesve kryesore të zhvillimit të shoqërisë dhe propozime të tjera që ndikojnë në rritjen e performancës së saj.

7. Projektprogrami për vitin pasardhës dërgohet prej drejtorisë së shoqërisë për miratim përfundimtar në asamblenë e aksionarëve të shoqërisë brenda datës 1 dhjetor të çdo viti. Në këtë rast, praktika e projektprogramit që dërgohet për miratim përfundimtar përmban:

- Relacionin shpjegues të drejtorisë së shoqërisë për projektprogramin.

- Tabelat e projektprogramit të shoqërisë, ku reflektohen sugjerimet që disponohen prej drejtorisë së shoqërisë.

- Një kopje të sugjerimeve që mund të jenë paraqitur prej ministrisë së linjës administrative lidhur

me projektprogramin e shoqërisë.

- Një kopje të vendimit miratues të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë për këtë projektprogram.

8. Të gjithë treguesit e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë duhet të bazohen në përllogaritje analitike të specialistëve, të kontrolluara prej drejtorisë së shoqërisë.

Përpiluesit e projektprogramit të zhvillimit dhe drejtoria e shoqërisë mbajnë përgjegjësi për bazueshmërinë në aktet ligjore e nënligjore në fuqi të përllogaritjeve analitike, mbi bazën e të cilave janë hartuar treguesit e propozuar për miratim.

9. Vetëm për raste të veçanta, kur ndryshimet e pjesshme gjatë vitit në programin e miratuar të shoqërisë diktohen nga faktorë të pamundur të parashikohen në projektprogram nga organet drejtuese të shoqërisë dhe janë objektivisht të pashmangshme, ndiqet e njëjta procedurë ndryshimi i programit të zhvillimit, si në rastin e miratimit të programit fillestar të shoqërisë.

10. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve raportojnë tek organet drejtuese të shoqërisë mbi realizimin operativ të treguesve kryesorë të programit vjetor të zhvillimit ekonomik dhe financiar. Afati i dërgimit të materalit të raportimit është sa herë që e gjykojnë të nevojshme ose t'u kërkohet prej tyre, por jo më rrallë se një muaj pas mbylljes së çdo 3-mujori.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

VENDIM
Nr.69, datë 12.12 .2007

PËR SHQYRTIMIN E TRANSFERIMIT TË LICENCËS NGA SHOQËRIA "HCA" SHPK TE SHOQËRIA "BALKAN GREEN ENERGY" SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22. 5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.467, datë 3.10.2002 "Për miratimin e kontratës koncensionare të formës ROT ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Ekonomisë nga njëra anë dhe shoqërisë italiane "Essegei" s.r.l nga ana tjetër për HEC-et vendore", vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 "Rregullore e procedurave të licencimit" neni 12, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003, pikat 1.3 dhe 1.4 të kushteve të licencës, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 7.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Balkan Green Energy" sh.p.k. për transferimin e licencës së dhënë nga ERE shoqërisë "HCA" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Licenca me nr.13, seria PV03K, datë 19.12.2003, dhënë shoqërisë "HCA" sh.p.k. t'i transferohet shoqërisë "Balkan Green Energy" sh.p.k.

2. Shoqëria "Balkan Green Energy" sh.p.k. mbart të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr.13, seria PV03K, datë 19.12.2003, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.20, datë 19.12.2003.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.70, datë 10.12 .2007

PËR SHQYRTIMIN E TRANSFERIMIT TË LICENCËS NGA SHOQËRIA "ESSEGEI SHQIPËRI SMOKTHINA" SHPK TE SHOQËRIA "ALBANIAN GREEN ENERGY" SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.445, datë 17.6.2001 "Për miratimin e kontratës koncensionare të formës ROT ndërmjet Ministrisë Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë italiane "Essegei" s.r.l për HEC-in e Smokthinës", vendimit të Bordit të

Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 "Rregullore e procedurave të licencimit" neni 12, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.15, datë 27.8.2003, pikat 1.3 dhe 1.4 të kushteve të licencës, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 7.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Albanian Green Energy" sh.p.k. për transferimin e licencës së dhënë nga ERE shoqërisë "Essegei Shqipëri Smokthina" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Licenca me nr.05, seria PO3K, datë 27.8.2003, dhënë shoqërisë "Essegei Shqipëri Smokthina" sh.p.k. t'i transferohet shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k.

2. Shoqëria "Albanian Green Energy" sh.p.k. mbart të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr.05, seria PO3K, datë 27.8.2003, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.15, datë 27.8.2003.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.71, datë 12.12.2007

PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE NGA SHOQËRIA "KESH" SHA TE SHOQËRIA "OSSH" SHA

Në mbështetje të nenit 9, nenit 20 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshimet përkatëse dhe nenit 8 të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", e miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.89, datë 13.12.2006, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 12.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "KESH" sh.a. për transferimin e aseteve te shoqëria "OSSH" sh.a.,

VENDOSI:

- Fillimin e procedurave për transferimin e aseteve për veprimtarinë e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike nga "KESH" sh.a. te shoqëria "OSSH" sh.a.
- Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara, në përputhje me kërkesat e "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.72, datë 12.12.2007

PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË "OSSH" SHA

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, pika 1, germa "c" dhe nenit 19, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshimet përkatëse dhe nenit 10, pika 1 të "Rregullave për procedurat e licencimit", Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 12.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "OSSH" sh.a., për licencim në aktivitetet e shpërndarjes së energjisë elektrike,

VENDOSI:

- Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "OSSH" sh.a., për licencimin në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara, në përputhje me kërkesat e "Rregullores për procedurat e licencimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.73, datë 12.12.2007

PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË "OSSH" SHA

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, pika 1, germa "ç" dhe nenit 19, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshimet përkatëse dhe nenit 10, pika 1 të "Rregullave për procedurat e licencimit", Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 12.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "OSSH" sh.a., për licencim në aktivitetet e furnizimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

- Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "OSSH" sh.a., për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
- Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara në përputhje me kërkesat e "Rregullores për procedurat e licencimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.74, datë 12.12.2007

PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË "OSSH" SHA

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, pika 1, germa "dh" dhe nenit 19, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshimet përkatëse dhe nenit 10, pika 1 të "Rregullave për procedurat e licencimit", Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 12.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "OSSH" sh.a., për licencim në aktivitetet e importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

- Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "OSSH" sh.a., për licencimin në aktivitetin e importit të energjisë elektrike.

- Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara, në përputhje me kërkesat e "Rregullores për procedurat e licencimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.75, datë 12.12.2007

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES HEC I KALIVACIT, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 39, pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 të "Rregullores për procedurat e licencimit" nenit 10, pika 1, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s" neni 18, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 "Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.67, datë 10.12.2007 "Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Kalivac Green Energy" sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i Kalivacit) si burim i rinovueshëm energjie", Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 12.12.2007, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria "Kalivac Green Energy" sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i Kalivacit), si burim i rinovueshëm energjie,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i Kalivacit), si burim i rinovueshëm energjie, i cili do të ndërtohet nga shoqëria "Kalivac Green Energy" sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.76, datë 14.12.2007

PËR REFUZIMIN E DHËNIES SË LICENCËS NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, SHOQËRISË "CERS" SHPK

Në mbështetje të nenit 9, pika 3, nenit 13, pika 1, germa "a", si dhe nenit 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe nenit 11 pika 1, nenit 13 pikat 1 dhe 2, nenit 14 të "Rregullores së procedurave të licencimit", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 14.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "CERS" sh.p.k., për licencim për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike,

VENDOSI:

- Refuzimin e dhënies se licencës për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike, shoqërisë "CERS" sh.p.k., për mospërmbushjen e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.

- Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojnë aplikuesin në lidhje me vendimin e marrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.77, datë 14.12.2007

PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË KONSUMIT VJETOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KONSUMATORËT JOFAMILJARË, PËR PËRFITIMIN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR

Në mbështetje të neneve 7 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, ligjit nr.9512, datë 10.4.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2007,

VENDOSI:

1. Të gjithë klientët jofamiljarë të energjisë elektrike kanë të drejtë të përfitojnë statusin e klientit të kualifikuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.78, datë 14.12.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.64, DATË 27.11.2007 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE "PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS SË SHOQËRISË "ENPOWER ALBANIA" SHPK, PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 9, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 19, pika 3 të "Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 për miratimin e "Rregullores për procedurat e licencimit", Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 14.12.2007,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit nr.64, datë 27.11.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

2. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, ta njoftojnë shoqërinë "Enpower Albania" sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.22, datë 12.12.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË PËRJASHTIMIT TË OPERACIONEVE HIDROKARBURE NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TVSH

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:
Z.Genc Ruli - kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi - anëtare
Znj. Mimoza Vokshi - anëtare
Z.Viktor Gumi - anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.12.2007, shqyrtoi raportin "Për skemën ekzistuese të përjashtimit të operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja". Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Drejtoria e Politikave Industriale/METE dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën nr.225/4, datë 7.3.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.Al/002/2005.

BAZA LIGJORE: Si bazë për përjashtimin e operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja është dekreti nr.782, datë 22.2.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)" dhe dekreti nr.1510, datë 28.6.1996 "Për një ndryshim në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", ndryshuar me ligjin nr.8070, datë 15.2.1996".

OBJEKTIVI/AT: Skema synon të lehtësojë zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjeve që operojnë në fushën e hidrokarbureve, nëpërmjet përjashtimit të operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja, duke mundësuar njëkohësisht zhvillimin social-ekonomik të zonave në të cilat është i autorizuar ushtrimi i kësaj veprimtarie.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema mbulon të gjitha ndërmarrjet, të cilat ushtojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në fushën e operacioneve hidrokarbure.

2. Skema synon të ndihmojë ndërmarrjet që nënshkruajnë "Marrëveshje hidrokarburesh" dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga detyrimet doganore për pajisjet, makineritë, materialet, si dhe një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, përjashtim i cili nuk jepet për sektorët e tjerë të ekonomisë.

3. Në sektorin e hidrokarbureve funksionon një sistem i veçantë fiskal. Ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë në këtë fushë, i nënshtrohen një tatimi mbi fitimin, në masën 50%.

4. Deri më sot, të gjitha ndërmarrjet që kanë ushtruar veprimtarinë e tyre në bazë të kësaj skeme, nuk kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit mbi fitimin, sepse nga aktiviteti i tyre nuk ka rezultuar zbulimi i naftës dhe më pas shfrytëzimi i rezervave të reja të naftës dhe gazit dhe rrjedhimisht nuk ka pasur shitje të produktit. Përjashtimi ekziston për ndërmarrjen e Bankers Petroleum Albania, e cila deri më sot nuk ka arritur të mbulojë me të ardhurat e saj kostot totale të aktivitetit të saj në përputhje me programin e zhvillimit. Mbështetur në këtë program, në vitin 2009, kjo ndërmarrje parashikon të realizojë një rezultat

financiar pozitiv, duke iu nënshtruar detyrimit për pagesën e tatim fitimit.

5. Aktualisht disa prej ndërmarrjeve janë duke kryer një veprimtari fitimprurëse nga nxjerrja, shitja dhe eksportimi i naftës dhe nënprodukteve të saj. Buxheti i Shtetit nuk ka njohur, deri në këtë periudhë, të ardhura nga aplikimi i faktorit R dhe nga tatimi mbi fitimin në kontratat me ndarje prodhimi për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve të lidhura mes METE dhe personave.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 13, shkronja "c" dhe nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën Shtetërore",

PROPOZON:

1. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të raportojë brenda datës 31 mars të çdo viti, të dhënat për rezultatet e zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure në vitin paraardhës financiar.

2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, të ruajë të dhënat për skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale deri pas 10 vjetësh nga data e përfundimit të marrëveshjes së fundit hidrokarbure në kuadër të zbatimit të këtij ligji.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr.23, datë 12.12.2007

PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT
PËR DISA KATEGORI TË NDIHMAVE HORIZONTALE

Në mbështetje të nenit 17, shkronja "e" të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", Komisioni i Ndihmës Shtetërore,

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit "Për disa kategori të ndihmave horizontale", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

UDHËZIM
PËR DISA KATEGORI TË NDIHMAVE HORIZONTALE

1. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM

1.1 Hyrje

Ndihma shtetërore shihet si një nga mekanizmat e ndërhyrjes së shtetit për të rregulluar dështimet e tregut. Megjithatë, shteti në të gjitha rastet e ndërhyrjes së tij, duhet të ketë si parim kryesor funksionimin normal të një ekonomie tregu, duke ruajtur një balancë me politikat e tjera për zhvillimin ekonomik e shoqëror të rajoneve të veçanta e të vendit në tërësi.

Kur ndihma shtetërore jepet për të nxitur realizimin e objektivave të tillë të përgjithshëm, si punësimi, kërkimi dhe zhvillimi, mbrojtja e mjedisit ose ruajtja e qëndrueshmërisë rajonale, ajo mund të pranohet, vetëm nëse investimi i ndërmarrë jep efekte pozitive për shoqërinë, efekte të cilat nuk do të mund të realizoheshin nga burimet financiare të vetë ndërmarrjeve. Me anë të një politike të drejtë ndihme, mund të rregullohet dhe përmirësohet situata në një sektor të caktuar apo të nxiten ndërmarrjet për realizimin e investimeve, që ndikojnë në plotësimin e standardeve apo ofrimin e shërbimeve publike. Megjithatë, forma të tjera të ndihmës që ndikojnë ndjeshëm në konkurrencën në treg dhe që nuk shoqërohen me përfitime të tjera, konsiderohen të paligjshme dhe, si të tilla dënohen. Kjo përligj kërkesën për një monitorim të fortë të ndihmës shtetërore, nëpërmjet përcaktimit të kritereve që duhet të ndiqen për vlerësimin apo kontrollin e masës së ndërhyrjes së shtetit në veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve.

Duke filluar nga data 1 janar 2006, në Republikën e Shqipërisë është në fuqi ligji nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore" dhe tri rregulloret në zbatim të tij "Për procedurat dhe formën e njoftimin", " Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale", si dhe "Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve në vështirësi".

Neni 17, shkronja "e" dhe neni 18, shkronja "f" i ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", ngarkon Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore, respektivisht për hartimin dhe nxjerrjen e udhëzimeve në zbatim të këtij ligji.

Qëllimi i këtij udhëzimi është lehtësimi i punës së dhënësve të ndihmës shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, nëpërmjet trajtimit më gjerësisht të koncepteve, kritereve dhe procedurave që zbatohen për disa kategori ndihmash horizontale, të përcaktuara në nenet 8, 9, 10, 11 dhe 12 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore".

Udhëzimi synon, në radhë të parë, të japë disa kritere të përgjithshme që përdoren në analizën dhe vlerësimin e skemave të ndihmës dhe të ndihmave individuale, për të parë shkallën e tyre të përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi të ndihmës shtetërore. Po këto kritere duhet të përdoren edhe nga dhënësit e ndihmës, gjatë procesit të përgatitjes së akteve të ndryshme normative që lidhen me planet për dhënien e ndihmës shtetërore.

Me qëllim që të sigurohet kuptimi dhe zbatimi i drejtë i rregullave të ndihmës shtetërore, si edhe për lehtësimin e procedurave, udhëzimi paraqet në mënyrë më të plotë përcaktimin e termave apo koncepteve bazë që janë të rëndësishme për disa kategori ndihmash horizontale, në nënndarjet respektive të tyre.

Në këtë udhëzim nuk përfshihen kategoria e ndihmave rajonale, si dhe ndihmat për shpëtimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve në vështirësi. Këto kategori rregullohen me rregullore të veçanta të miratuara, përkatësisht, me vendimet nr.815 dhe nr.816 të Këshillit të Ministrave të datës 28.12.2005.

1.2 Intensiteti i ndihmës dhe kostot e pranueshme

Në mënyrë që të garantohet se ndihma është proporcionale me mangësitë që kërkon të rregullojë dhe e kufizuar vetëm në sasinë e domosdoshme, vlera e saj përcaktohet në formën e intensitetit të ndihmës që i referohet kostove të pranueshme të investimit.

Kufijtë e lejuar të intensitetit të ndihmës apo të vlerës së ndihmës përcaktohen në atë nivel që lejon vendosjen e balancës së duhur midis uljes në maksimum të efektit shtrembërues në konkurrencë për sektorin që përfiton ndihmë dhe zgjidhjes së problemeve respektive të dështimit të tregut apo të kohezionit social.

Gjithashtu, për të parë respektimin e kufijve maksimalë të intensitetit, analizohet dhe vlerësohet shuma totale e ndihmës për një veprimtari apo projekt të caktuar, pavarësisht nëse mbështetja është dhënë nga Buxheti i Shtetit, buxheti i qeverisjes vendore, apo nga donatorët.

Në llogaritjen e intensitetit të ndihmës, të gjitha të dhënat e përdorura duhet të merren përpara zbritjes së taksimit të drejtpërdrejtë. Kur ndihma nuk është dhënë në formë granti, por në ndonjë formë tjetër, atëherë vlera e ndihmës do të jetë ekuivalenti i grantit të ndihmës.

Ndihma e pagueshme në disa këste duhet të skontohet në vlerën e saj në momentin e dhënies. Norma e interesit që do të përdoret për skontimin dhe për llogaritjen e vlerës së ndihmës në formën e një kredie të zbutur do të jetë norma e referencës së përdorur në momentin e dhënies. Në rastet kur ndihma jepet në formën e përjashtimit nga taksat apo heqjen e detyrimit nga taksat në të ardhmen, skontimi i ndihmës bëhet në bazë të normës së referencës së aplikuar në momentin që ky avantazh bëhet efektiv.

Kostot e pranueshme duhet të jenë të dokumentuara qartë dhe të specifikuara, duke iu referuar llojit apo kategorisë përkatëse të ndihmës shtetërore.

1.3 Ndihma transparente

Përgjithësisht, për të siguruar transparencën, trajtimin e njëjtë, si dhe një monitorim efektiv, konsiderohen si ndihma të lejueshme ato ndihma që janë transparente.

Në vlerësimin e legjislacionit të ndihmës shtetërore, përveç granteve të drejtpërdrejta, konsiderohen ndihma transparente:

i) ndihma në formën e huave, ku llogaritja e ekuivalentit të grantit për ndihmën është bërë mbi bazën e normave të interesit që mbizotërojnë në treg në momentin e dhënies së grantit, si dhe merr parasysh ekzistencën e një siguracioni normal dhe/ose parashikimin e një risku normal lidhur me huanë;

ii) ndihma në formën e garancive, për të cilën metodologjia e llogaritjes së ekuivalentit bruto të grantit, është përcaktuar në rregulloren "Për procedurat dhe formën e njoftimit", të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005;

iii) ndihma në formën e lehtësirave të ndryshme fiskale, nëse ajo ka të përcaktuar një tavan që nuk tejkalon intensitetin maksimal të lejuar.

Sipas legjislacionit të ndihmës shtetërore, nuk konsiderohen ndihma transparente:

i) ndihma në formën e injektimit/shtimit të kapitalit;

ii) ndihma në formën e riskut të kapitalit.

Për sa i takon ndihmës në formën e parapagesës, ajo do të konsiderohet si ndihmë transparente, vetëm në rast se shuma e parapaguar nuk tejkalon intensitetin maksimal të lejuar për kategorinë përkatëse. Në rast se vlera e ndihmës është shprehur në formën e intensitetit të ndihmës, shuma totale e parapagesës, e shprehur si një përqindje e kostove të pranueshme, nuk duhet të kalojë intensitetin e ndihmës së zbatuar për kategorinë përkatëse.

1.4 Efekti nxitës i ndihmës

Për të siguruar që ndihma është absolutisht e domosdoshme dhe që ajo vepron si një nxitës për ndërmarrjet përfituese për të zhvilluar veprimtari apo për të nisur projekte të reja, ajo nuk jepet për veprimtari apo projekte, të cilat ndërmarrjet do t'i ndërmerrnin vetë, në kushte normale tregu. Prandaj, udhëzimi trajton ato kategori ndihmash, të cilat kanë një efekt nxitës.

Konsiderohet ndihmë që ka një efekt nxitës, ajo ndihmë që i mundëson përfituesit të kryejnë aktivitete ose projekte, të cilat nuk do të mund t'i vinte në zbatim në mungesë të saj.

Në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ato duhet të kenë dorëzuar një aplikim për ndihmë te dhënësi i ndihmës, përpara se të ketë filluar puna në projektin apo veprimtarinë që synohet të ndihmohet.

Ndërsa për ndërmarrjet e mëdha, dhënësi i ndihmës nuk mund të japë ndihmën individuale të parashikuar, pa verifikuar më parë që dokumentacioni i paraqitur nga përfituesi i ndihmës vërteton efektin nxitës të ndihmës, nëpërmjet plotësimit të një ose më shumë prej kritereve të mëposhtme:

i) rritjen e madhësisë së projektit/aktivitetit;

ii) shtimin e objektivave që realizohen nëpërmjet projektit/aktivitetit;

iii) rritjen e vlerës totale të shpenzuar nga përfituesi mbi projektin/aktivitetin.

Kemi parasysh që këto kërkesa nuk zbatohen për masat fiskale të përgjithshme, që përcaktohen në bazë të kritereve objektive dhe pa lejuar ushtrimin e kompetencave diskrecionare nga dhënësi i ndihmës, gjithmonë, nëse këto masa fiskale janë vënë në zbatim përpara se të fillonte puna mbi projektet apo aktivitetet që përfitojnë ose që mund të përfitojnë prej tyre.

Në rast se nuk përmbushen kriteret e mësipërme, masa e ndihmës nuk mund të hyjë në kategorinë e ndihmave të lejueshme.

1.5 Transparenca dhe monitorimi

Dhënësit e ndihmës duhet të mbajnë të regjistruara të dhëna të hollësishme për çdo ndihmë individuale apo skemë ndihme të trajtuar nga ky udhëzim. Regjistrat e të dhënave duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të vendosur se janë përmbushur të gjitha kushtet për përfitimin e ndihmës, duke përfshirë informacionin mbi statusin e ndërmarrjes si SME-të, apo ndërmarrje e madhe, informacionin mbi efektin nxitës të ndihmës, si dhe informacionin që bën të mundur përcaktimin e një shume fikse të kostove të pranueshme të investimit.

Dhënësit e ndihmës duhet të mbajnë të regjistruara të dhënat për ndihmën individuale për 10 vjet nga data e dhënies së saj, ndërsa për skemat e ndihmës, për 10 vjet nga data e dhënies së ndihmës së fundit në bazë të skemës.

2. NDIHMA PËR SME-të

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme luajnë një rol vendimtar në krijimin e vendeve të punës. Më gjerësisht, ato veprojnë si një faktor nxitës i stabilitetit social dhe ekonomik. Megjithatë, zhvillimi i tyre mund të kufizohet nga defektet e tregut. Shpesh ato kanë vështirësi në sigurimin e kapitalit apo kredisë, për shkak të natyrës së veçantë të disa tregjeve financiare dhe garancive të kufizuara që ato mund të jenë në gjendje të ofrojnë. Burimet e tyre të pakta mund të kufizojnë marrjen e informacioneve, veçanërisht të atyre që kanë lidhje me teknologjinë e re dhe tregjet e mundshme.

Nuk hyjnë në kategorinë e ndihmave të lejueshme:

i) ndihma në veprimtaritë e lidhura me eksportin, të quajtura ndryshe ndihma të lidhura me sasinë e eksportuar, për ngritjen dhe zhvillimin e një rrjeti shpërndarjeje ose të shpenzimeve të tjera që lidhen me veprimtarinë e eksportit;

ii) ndihma që krijojnë përparësi për produktet e brendshme kundrejt atyre të importuara.

Ndërsa veprimtaritë e lidhura me prodhimin, përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, të listuara në protokollin II të MSA-së dhe MI-së, për periudhën transitore nuk hyjnë në fushën e zbatimit të legjislacionit të ndihmës shtetërore. Ato trajtohen sipas rregullave të tregut të përbashkët bujqësor, të përcaktuar në marrëveshjen e OBT-së, si dhe sipas dispozitave të kapitullit II të MSA-së.

2.1 Kushtet që një ndihmë për SME-të të konsiderohet e lejueshme

Ndihma individuale jashtë skemave, do të konsiderohet e lejueshme, vetëm në rast se ajo njoftohet në Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore, duke pasur një referencë të qartë në legjislacionin e ndihmës shtetërore dhe miratohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

Ndihmat që u jepen ndërmarrjeve në kuadër të një skeme ndihme, që përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara, nuk do të jetë subjekt njoftimi individual në Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore, vetëm në rastet kur skema ka marrë paraprakisht miratimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe çdo ndihmë që mund të jepet sipas kësaj skeme, ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në vendimin përkatës të KNSH-së.

Pavarësisht se ndihma mund të hyjë në kategorinë e ndihmave që lejohen, në asnjë rast ajo nuk vihet në zbatim përpara se Komisioni të marrë një vendim për lejimin e saj, me ose pa kushte.

2.2 Përkufizime

Për shpjegim më të mirë të kësaj nënndarje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) "investim fillestar" është investimi në kapital të patundshëm për ngritjen e një ndërmarrjeje të re; për zgjerimin e një ndërmarrjeje ekzistuese; për rritjen e llojshmërisë së produkteve, nëpërmjet prodhimit të produkteve të reja tregtare, për ndryshime thelbësore të produkteve ose të proceseve të prodhimit; si dhe për blerjen e një ndërmarrjeje, një linje prodhimi apo dege të saj, që është mbyllur ose që do të mbyllej, nëse nuk do të blihej;

b) "numri i punonjësve" është numri i njësive vjetore të punës, që do të thotë numri i personave të punësuar me kohë të plotë gjatë një viti. Personat e punësuar me kohë të pjesshme dhe ata sezonalë do të llogariten si fraksione të numrit të njësive vjetore të punës;

c) "punonjës në vështirësi" është çdo person që i përket një kategorie shoqërore, e cila pa pasur një përkrahje e ka të vështirë të hyjë në tregun e punës, kryesisht një person që përmbush të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

i) çdo person nën moshën 25 vjeç ose që ka dy vjet që ka mbaruar arsimin pa shkëputje nga puna dhe që nuk ka pasur një punë të parë të rregullt dhe të paguar;

ii) çdo person që është një anëtar i një minoriteti etnik brenda vendit dhe që kërkon zhvillimin e aftësive të tij/saj ligjore, trajnim profesional ose përvojë pune për të përmirësuar shpresat e tij për të filluar një punë të qëndrueshme;

iii) çdo person që dëshiron të hyjë ose të rihyjë në punë, që ka qenë pa punë dhe që nuk ka qenë duke u arsimuar për dy vitet e fundit, veçanërisht çdo person, që lë punën për shkak të vështirësive për të përballuar edhe punën edhe familjen:

iv) çdo person që jeton si beqar i rritur dhe që ka në ngarkim një ose më shumë fëmijë;

v) çdo person që nuk ka kryer arsimin e mesëm ose ekuivalentin e tij, që nuk ka një punë ose që ka humbur punën e tij/saj;

vi) çdo person më i madh se 50 vjeç, që nuk është në punë ose që ka humbur punën e tij/saj;

vii) çdo person që ka një periudhë të gjatë pa punë, p.sh. çdo person që ka qenë pa punë për 12 nga 16 muajt e fundit, ose, për personat nën 25 vjeç, gjashtë nga tetë muajt e fundit;

viii) çdo person që nuk ka filluar punën e tij të parë të rregullt dhe të paguar që nga fillimi i periudhës së burgosjes ose masave të tjera penale;

d) "punonjës me aftësi të kufizuar" është çdo person i cili njihet si i tillë në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi ose ka një dëmtim fizik, mendor dhe psikologjik serioz dhe të njohur, pra nuk është i aftë të zërë një vend pune në tregun e hapur të punës;

e) "punësimi i shtresave që merren nën mbrojtje" do të thotë punësimi në një ndërmarrje ku të paktën 50% e të punësuarve janë punonjës më aftësi të kufizuar.

2.3 Kushtet e dhënies së ndihmës për investim për SME-të

Ndihma për SME-të për investim në asete të prekshme dhe të paprekshme do të konsiderohet ndihmë e lejueshme nëse përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 13 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore".

Megjithatë, për ndihmën për investim fillestar për SME-të mund të zbatohen edhe kufijtë e intensitetit të përcaktuar në nenet 4 dhe 5 të rregullores "Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale", miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815.

Nëse ndihma për SME-të jepet në kuadër të ndihmës rajonale për investim, mund të zbatohet kufiri maksimal i intensitetit, vetëm nëse ndihma është dhënë me kushtin që investimi të ruhet për të paktën pesë

vjet, në rajonin përkatës dhe që kontributi i përfituesit të jetë të paktën 25%.

Kufijtë e përcaktuar duhet të zbatohen për intensitetin e ndihmës së llogaritur si përqindje e kostove të pranueshme të investimeve ose si përqindje e kostove të pagave për vendet e punës të krijuara nga kryerja e një investimi (ndihma për krijimin e vendeve të reja të punës), ose si një kombinim i tyre që parashikon se, me çfarëdo llogaritje, ndihma nuk kalon kufirin maksimal të lejuar.

Në rastet kur ndihma llogaritet në bazë të kostove të investimit, kostot e pranueshme të investimeve të prekshme duhet të jenë kostot që lidhen me investimet për tokën, ndërtesat, makineritë dhe pajisjet.

Ndërsa kostot e pranueshme të investimeve të paprekshme janë kostot që lidhen me transferimin e teknologjisë, nëpërmjet zotërimit të patentave, licencave operacionale dhe licencave të njohurive, të mbrojtura dhe të pambrojtura, me kusht që ato:

i) të përdoren vetëm në ndërmarrjen, linjën apo degën e saj, për të cilën merret ndihma rajonale;

ii) të konsiderohen si aktive të amortizueshme;

iii) të blihen nga palët e treta me kushtet e tregut;

iv) të përfshihen në aktivet e ndërmarrjes, linjës apo degës së saj, që merr ndihmë rajonale dhe të qëndrojnë në të për një periudhë jo më pak se pesë vjet.

Në sektorin e transportit, me përjashtim të inventarit hekurudhor, mjetet dhe pajisjet e transportit nuk duhet të përfshihen në kostot e pranueshme. Kostot e pranueshme për investimet e paprekshme, në këtë sektor, duhet të jenë kostot e përvetësimit të teknologjisë.

2.4 Kushtet e dhënies së ndihmës për punësim për SME-të, në kuadër të ndihmës rajonale

Në rastet kur ndihma llogaritet në bazë të krijimit të vendeve të reja të punës, masa e ndihmës duhet të shprehet në përqindjen e kostove të pagave për një periudhë dyvjeçare, duke u lidhur me krijimin e vendeve të punës sipas kushteve të mëposhtme:

i) krijimi i vendeve të reja të punës është i lidhur me zbatimin e një projekti investimi në asete të prekshme dhe të paprekshme. Vendet e punës duhet të krijohen brenda tri viteve nga përfundimi i investimit;

ii) projekti i investimit ndiqet nga një rritje e numrit të punonjësve në ndërmarrjet përkatëse, duke u krahasuar me mesataren e dymbëdhjetë muajve të mëparshëm; dhe

iii) vendet e reja të punës duhet të mbahen për një periudhë minimale prej pesë vjetësh.

2.4.1 Punësimi i punonjësve në vështirësi dhe i punonjësve me aftësi të kufizuara në formën e subvencioneve të pagës

Intensiteti i ndihmës në rastin e skemave të ndihmës për punësimin e punonjësve në vështirësi nuk duhet të kalojë 50% të kostove të pranueshme, ndërsa në rastin e skemave për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuara, intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 60% të kostove të pranueshme, duke zbatuar kushtet në vazhdim:

i) kur punësimi nuk përfaqëson një rritje neto të numrit të punonjësve në ndërmarrjen në fjalë, vendi ose vendet e punës duhet të jenë lënë vakant nga një largim vullnetar, dalje në pension, ulje vullnetare e orëve të punës ose largim i ligjshëm nga puna për sjellje të keqe dhe jo si rezultat i ristrukturimit për shkak të numrit të tepërt të punonjësve; dhe

ii) përveç rasteve të pushimit të ligjshëm nga puna për sjellje të keqe, punëtori ose punëtorët duhet të mbahen në punë pa shkëputje për të paktën 12 muaj.

Kostot e pranueshme duhet të jenë kostot e pagës, të llogaritura mbi një periudhë maksimale prej 12 muajsh.

2.4.2 Kostot shtesë për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuara

Që të konsiderohen të lejueshme, skemat e ndihmës për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuara dhe çdo ndihmë që mund të jepet sipas këtyre skemave, duhet të përmbushë edhe disa kushte të tjera.

Ndihma për punësim, së bashku me çdo ndihmë të dhënë, nuk duhet të kalojë nivelin e dëshiruar për kompensimin e:

- produktivitetit të ulur për shkak të paaftësisë të punëtorit ose punëtorëve,
- kostove për përshtatjen e godinave,
- kostot e stafit të punësuar vetëm për kohën që harxhohet për asistencën e punëtorit ose punëtorëve me aftësi të kufizuara, dhe
- kostot e përshtatjes ose blerjes së pajisjeve për përdorimin e tyre,

të cilat janë shtesë e atyre kostove që përfituesi do të përballonte nëse do të punësonte punonjës të

tjerë, gjatë një periudhe për të cilën janë të punësuar punonjësit me aftësi të kufizuara.

Kur përfituesi ofron punësim duke garantuar mbrojtjen e kategorive të caktuara të punonjësve, ndihma mund të konsiderohet e lejueshme, por me kusht që të mos kalojë kostot e ndërtimit, instalimit ose zgjerimit të ndërmarrjes në fjalë, si edhe çdo kosto administrimi dhe transporti, të cilat rezultojnë nga punësimi i këtyre kategorive.

2.4.3 Masa që nuk konsiderohen ndihma të lejueshme për punësim

Skemat e ndihmës për punësim, që jepen vetëm për sektorë të veçantë, në parim nuk hyjnë në kategorinë e ndihmave të lejueshme.

Vëmendja e Komisionit të Ndihmës Shtetërore do të përqendrohet në ndihmat individuale, pra që jepen për një ndërmarrje të vetme, si dhe për ato skema ndihme për nxitjen e marrjes në punë të kategorive të punonjësve, që nuk konsiderohen në vështirësi apo nuk janë me aftësi të kufizuara. Në njoftim, dhënësit e ndihmës do të paraqesin për vlerësim argumentet dhe të gjithë indikatorët ekonomikë që tregojnë se punonjësit apo ndërmarrjet në fjalë kanë realisht nevojë për një mbështetje të tillë.

Gjithashtu, me shumë vëmendje do të shqyrtohet ndihma për të mbajtur vendet e punës, kryesisht mbështetja financiare e dhënë për një ndërmarrje për të mbajtur ende në punë punonjësit të cilët, në të kundërt do të pushoheshin. Për çdo rast të tillë, plani për dhënien e ndihmës do të njoftohet pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore. Në varësi të ndonjë rregulli të veçantë sektorial, një ndihmë e tillë mund të miratohet nga Komisioni, vetëm nëse ajo synon të rregullojë dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose rrethana të jashtëzakonshme, ose sipas kushteve të zbatuara për ndihmën rajonale, pra që të jetë e lidhur me zhvillimin ekonomik të zonave ku standardi i jetesës është jashtëzakonisht i ulët ose kur ekziston një papunësi e lartë.

Po në këtë kontekst do të shqyrtohet ndihma për shndërrimin e kontratave të përkohshme ose të pandryshuara të punësimit në kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar, si dhe skemat e ndihmës për ndarjen e punës, për ofrimin e mbështetjes për patentat e punës dhe masa të ngjashme punësimi, të cilat nxisin punësimin, por që nuk çojnë në një rritje neto të punësimit, në marrjen në punë të punonjësve në vështirësi ose të punonjësve me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, masa të tjera ndihme që lidhen me punësimin dhe tregjet e punës, të tilla si: masat për të nxitur daljen para kohe në pension, si dhe rastet individuale të ndihmës për punësim, të dhëna jashtë ndonjë skeme, do të kërkojnë njoftime të veçanta pranë DNSH. Kategori të tilla do të vlerësohen në bazë të legjislacionit dhe mund të miratohen nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, vetëm nëse janë në përputhje me ndonjë rregull të veçantë, i cili mund të jetë miratuar për sektorin në të cilin vepron përfituesi dhe, vetëm nëse mund të tregohet që efektet e ndihmës në punësim janë më të mëdha se ndikimi në konkurrencë në tregun përkatës.

2.5 Ndihma për SME-të në formën e shërbimeve këshillimore

Që ndihma për shërbime këshillimore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të konsiderohet e lejueshme, duhet që intensiteti i saj të mos kalojë 50% të kostove të pranueshme. Kostot e pranueshme duhet të jenë kostot e këshillimit për shërbimet e ofruara nga konsulentë të jashtëm.

Shërbimet e lartpërmendura nuk duhet të jenë aktivitete në vazhdimësi apo periodike dhe që lidhen me kostot operacionale të zakonshme të ndërmarrjes ose shpenzimet korrente, siç mund të jenë shërbimet këshillimore për taksat, shërbimet ligjore apo reklamat.

2.6 Ndihma për pjesëmarrjen e SME-ve në panaire

Ndihma për pjesëmarrjen në panaire të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme do të quhet e lejueshme nëse intensiteti i ndihmës nuk kalon 50% të kostove të pranueshme. Kostot e pranueshme duhet të jenë kostot që shërbejnë për dhënien më qira, ngritjen dhe funksionimin e stendave apo të vendqëndrimit për pjesëmarrjen e parë të një ndërmarrjeje në një panair apo ekspozitë të veçantë.

3. NDIHMA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM

Ndihma për kërkim dhe zhvillim kontribuon në rritjen e ekonomisë, forcimin e konkurrencës dhe rritjen e nivelit të punësimit. Duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara që kanë jo vetëm SME-të, por dhe ndërmarrjet e mëdha për të kryer kërkim dhe zhvillim, defektet e tregut mund t'i pengojnë ato në arritjen e një prodhimi optimal. Kjo do të sjellë rezultate të dobëta, të cilat lidhen kryesisht me eksternalitetet pozitive[1], mallrat publikë, informacionin asimetrik, rrjetin dhe koordinimin e defekteve.

Ndihma për kërkim dhe zhvillim është, veçanërisht e rëndësishme për SME-të, sepse një nga mangësitë e tyre strukturore, ka të bëjë pikërisht me vështirësinë për të pasur akses në zhvillimet e reja të teknologjisë, transferimin e teknologjisë ose të burimeve njerëzore shumë të kualifikuara. Ndaj ndihma për projektet për kërkim dhe zhvillim për SME-të, ndihma për kryerjen e studimeve teknike dhe ndihma për

[1] Externalitete positive ekzistojnë kur përfitimi shtesë i shoqërisë nga prodhimi ose konsumi e tejkalon përfitimin marxhinal të ndërmarrjes.

mbulimin e kostove mbi të drejtat e pronësisë industriale, përgjithësisht, konsiderohen ndihma që mund të lejohen.

3.1 Përkufizime

Për shpjegim më të mirë të kësaj nënndarje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) "organizatë kërkimore" do të thotë një entitet, siç mund të jetë një universitet apo institut kërkimi, i pavarur nga statusi i tij ligjor (person juridik, privat apo publik) ose nga mjetet e tij të financimit, tek i cili qëllimi kryesor është të drejtojë kërkime bazë, kërkime industriale apo zhvillime eksperimentale dhe të përhapë rezultatet e tyre me anë të mësimit, publikimit apo teknologjisë. Të gjitha përfitimet duhet të riinvestohen në këto veprimtari, me anë të përhapjes së rezultateve të tyre apo mësimit;

b) "kërkim bazë" do të thotë punë eksperimentale apo teorike, e ndërmarrë fillimisht për të siguruar njohuri të reja, mbi bazën e fenomeneve dhe fakteve të dukshme dhe pa pasur një zbatim të drejtpërdrejtë praktik ose përdorim të tyre;

c) "kërkim industrial" do të thotë kërkim i planifikuar apo hetim vendimtar që ka si qëllim sigurimin e njohurive të reja dhe aftësive për të krijuar produkte të reja, procese apo shërbime, ose për të sjellë një përmirësim të dukshëm në produktet, proceset apo shërbimet ekzistuese. Kërkimi industrial përfshin edhe krijimin e pjesëve përbërëse të sistemit, të nevojshme për realizimin e kërkimit industrial, veçanërisht për miratimin e teknologjisë së përgjithshme;

d) "kërkim parakonkurrues" do të thotë sigurimi, kombinimi, formimi dhe përdorimi i bizneseve ekzistuese specifike dhe teknologjike, si dhe i njohurive dhe aftësive të tjera të nevojshme, me qëllim përgatitjen e planeve dhe marrjen e masave për produktet e reja, për proceset ose shërbimet që ndryshohen apo përmirësohen. Këtu mund të përfshihen edhe aktivitete të tjera që kanë si qëllim saktësimin konceptual, planifikimin dhe dokumentimin e produkteve të reja, proceseve apo shërbimeve. Aktivitetet mund të përfshijnë planprodhimin, planet studimore dhe dokumente të tjera, por që nuk përdoren për qëllime tregtare. Zhvillimi eksperimental nuk përfshin ndryshimet rutinë apo periodike të produkteve, të linjave të prodhimit, të industrisë përpunuese, të shërbimeve ekzistuese dhe veprimtarive të tjera në proces, edhe kur këto ndryshime paraqesin përmirësim;

e) "prototip" është produkti final tregtar dhe, kur është tejet i shtrenjtë, prodhimi i tij vetëm për t'u përdorur për qëllime demonstrimi dhe miratimi. Në rast përdorimi të tillë, të ardhurat që sigurohen nga ky përdorim duhet të zbriten nga kostot e pranueshme. Konsiderohen si kosto të pranueshme për prototipet, kostot e prodhimit dhe testimit eksperimental të produkteve, të proceseve dhe të shërbimeve, me kushtin që këto të përdoren apo transformohen në fushën industriale apo tregtare.

3.2 Ndihma për projektet për kërkim dhe zhvillim

Ndihma për projektet për kërkim dhe zhvillim vlerësohet në bazë të shkallës së saj të përputhshmërisë dhe plotësimit të kushteve të përcaktuara.

Në rastin e dhënies së ndihmës, pjesët e asistuara të projektit, duhet të përfshijnë kategoritë e kërkimit bazë, kërkimit industrial dhe zhvillimit eksperimental.

Kur një projekt përfshin detyra të ndryshme, çdo detyrë duhet të cilësohet nën një nga kategoritë e mësipërme, ose mund të mos cilësohet në asnjërën prej këtyre kategorive.

Ndonëse intensiteti maksimal i ndihmës nuk duhet të kalojë:

i) 100% për kërkimin bazë,

ii) 60% për kërkimin industrial, dhe

iii) 35%% për kërkimin parakonkurrues,

intensiteti i ndihmës për kërkimin industrial dhe atë parakonkurrues mund të shkojë deri në kufijtë maksimalë të lejuar me rregulloren "Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale".

Në rastin e ndihmës shtetërore për projektet për kërkim dhe zhvillim, të zbatuara në bashkëpunim me organizata dhe ndërmarrje ndërkombëtare, intensiteti i ndihmës llogaritet duke akumuluar ndihmën e marrë nga Buxheti i Shtetit me kontributin e dhënë për atë projekt prej organizatave ndërkombëtare dhe/apo kërkimore.

Kostot e pranueshme, në këtë rast, janë:

i) kostot e personelit (punonjësit kërkimorë-shkencorë, teknikët dhe pjesa tjetër e stafit mbështetës të punësuar mbi këtë projekt);

ii) kostot për mjetet dhe pajisjet për periudhën e përdorur për projektin kërkimor;

iii) kostot për ndërtesat dhe tokën, për kohëzgjatjen e projektit kërkimor. Për sa i përket ndërtesave, quhen kosto të pranueshme vetëm ato të amortizimit që lidhet me jetëgjatësinë e projektit, i llogaritur mbi bazën normave përkatëse të amortizimit, të përcaktuara në kontabilitet;

iv) kostot për shërbimet e këshillimit, njohuri teknike dhe blerjen e patentave apo licencave nga

burime jashtë projektit me kosto të tregut, ku transaksioni është zbatuar dhe nuk ka pasur asnjë marrëveshje të fshehtë, si dhe kostot për kështillim dhe shërbimet ekuivalente të përdorura ekskluzivisht për aktivitetin kërkimor;

v) shpenzime shtesë, si pasojë e projektit kërkimor;

vi) shpenzime të tjera operative, që përfshijë kostot për materiale, për furnizim apo produkte të barasvlershme, si rrjedhim i drejtpërdrejtë i aktivitetit kërkimor.

3.3 Ndihma për kryerjen e studimeve teknike

Në ndihmën për kërkim dhe zhvillim hyn edhe ndihma për kryerjen e studimeve teknike paraprake të kërkimeve industriale apo kërkimit parakonkurrues. Kostot e pranueshme, në këtë rast, janë kostot e studimit.

3.4 Ndihma për mbulimin e kostove të të drejtave të pronësisë industriale për SME-të

Edhe ndihma për përballimin e kostove që lidhen me marrjen dhe vërtetimin e patentave dhe të drejtave të tjera të pronësisë industriale mund të lejohet, nëse intensiteti i ndihmës nuk tejkalon kufijtë maksimalë të intensitetit, sipas kategorive përkatëse të kërkimit, të përcaktuara në pikën 3.1.

Kostot e pranueshme, në këtë rast, do të konsiderohen:

i) të gjitha kostot që paraprijnë grantin për të drejtën në shkallën e parë, duke përfshirë këtu edhe kostot që lidhen me përgatitjen, plotësimin dhe ndjekjen e aplikimit, si dhe kostot që rrjedhin nga përsëritja e aplikimit përpara se të jepet e drejta;

ii) përkthimi dhe kosto të tjera, si pasojë e dhënies apo vërtetimit të së drejtës në instanca të tjera gjyqësore;

iii) kosto që vijnë nga vërtetimi i së drejtës gjatë një akuze zyrtare të zbatimit dhe kundërshtimin e mundshëm të një akti, edhe në rast se këto kosto vijnë pas dhënies së të drejtës.

4. NDIHMA PËR TRAJNIM

Trajnimi sjell efekt pozitiv për shoqërinë, sepse ai rrit numrin e punonjësve të trajnuar duke përmirësuar konkurrencën në industrinë vendase dhe duke luajtur një rol të rëndësishëm në strategjinë e punësimit në vend. Trajnimi, përfshirë këtu edhe njohurinë mbi elektronikën, është i rëndësishëm për krijimin, përvetësimin dhe përhapjen e njohurive, pra konsiderohet me rëndësi të madhe publike. Ndaj ndihma për trajnim hyn në kategorinë e ndihmave që mund të lejohen.

Ndihma për trajnimin e përgjithshëm ka efekt më të vogël në shtrembërimin e konkurrencës, që do të thotë se për të mund të lejohen kufij më të lartë të intensitetit. Trajnimi i veçantë, në të cilën përfituesi kryesor është ndërmarrja, sjell një rrezik më të lartë për dëmtimin e konkurrencës, prandaj, kufiri i lejuar i intensitetit të ndihmës duhet të jetë më i vogël.

4.1 Përkufizime

Për shpjegim më të mirë të kësaj nënndarje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) "trajnimi specifik" është trajnimi që përfshin shkollimin e drejtpërdrejtë dhe në parim të zbatueshëm për punonjësit ekzistues ose vendet e ardhshme të punës në ndërmarrjet e ndihmuara dhe që siguron kualifikime, të cilat nuk janë të transferueshme ose janë shumë pak të transferueshme te ndërmarrjet ose sektorët e tjerë;

b) "trajnim i përgjithshëm" është trajnimi që përfshin shkollimin që nuk është i zbatueshëm vetëm ose kryesisht për punonjësit ekzistues dhe për vendet e ardhshme të punës në ndërmarrjet e ndihmuara, por që siguron kualifikime që janë shumë të transferueshme te ndërmarrjet ose sektorët e tjerë dhe, në këtë mënyrë, përmirëson dukshëm mundësinë e punonjësve për të gjetur punë.

Trajnimi do të konsiderohet "i përgjithshëm" nëse, për shembull:

- ai është i organizuar së bashku nga disa ndërmarrje të pavarura ose, nëse punonjësit në ndërmarrje të ndryshme mund të vetë trajnohen;

- ai njihet, certifikohet ose vërtetohet nga autoritetet ose organet publike ose nga organe apo institucione të tjera, të cilit i është dhënë autoriteti i nevojshëm për këtë.

4.2 Kushtet e dhënies së ndihmës për trajnim

Në rastet kur projekti i ndihmës përfshin elemente si të trajnimit specifik, ashtu edhe trajnimit të përgjithshëm, të cilët nuk mund të ndahen për llogaritjen e intensitetit të ndihmës, si dhe në rastet kur nuk mund të përcaktohet karakteri specifik ose i përgjithshëm i ndihmës për trajnim, intensitetet e zbatueshme do të jenë ato të trajnimit specifik.

Kostot e pranueshme në ndihmën për trajnim konsiderohen:

i) kostot personale të trajnuesve;

ii) shpenzimet e udhëtimit të trajnuesve dhe të të trajnuarve;

iii) shpenzime të tjera qarkulluese, të tilla si: materialet dhe furnizimet;

iv) amortizimi i mjeteve dhe pajisjeve në masën që ato përdoren vetëm për projektin e trajnimit;

v) kostoja e udhëzimit dhe shërbimeve këshillimore që lidhen me projektin e trajnimit;

vi) kostot personale të të trajnuarve deri në vlerën e totalit të kostove të tjera të pranueshme të referuara në "a" deri "e". Mund të llogariten vetëm orët gjatë të cilave të trajnuarit marrin pjesë në trajnim, pas zbritjes së ndonjë ore prodhuese ose ekuivalentit të tyre.

Kostot e pranueshme duhet të shoqërohen me të dhëna të dokumentuara, të cilat duhet të jenë transparente.

5. NDIHMA PËR RISKUN E KAPITALIT

Një nga arsyet e defekteve në treg është ekzistenca e riskut të kapitalit. Shpesh, ndërmarrjet nuk kanë mundësi të sigurojnë burime financiare, megjithëse zotërojnë një plan biznesi të mirë, që premton për shëndoshjen financiare të tyre. Shkaku kryesor i defekteve në treg, që ndikon në mundësinë për sigurimin e kapitalit, veçanërisht nga vetë SME-të, është informacioni asimetrik. Skemat e riskut të kapitalit për SME-të, që marrin formën e burimeve të investimit, në të cilën një pjesë e konsiderueshme e burimeve vijnë si kapital privat, mund të konsiderohen ndihma të lejueshme.

5.1 Përkufizime

Për shpjegim më të mirë të kësaj nënndarje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) "kapital i vet" kupton pretendimin e pronarëve të ndërmarrjes, që përfaqësohen nga aksionet që janë emetuar për themeluesit e saj;

b) "kapital potencial" kupton instrumentet financiare, kthimi i të cilave për mbajtësin e saj bazohet në fitimin ose humbjet që parashikon ndërmarrja dhe nuk janë të sigurta në rast mospagimi;

c) "kapital privat" kupton kapitalin ose investimin në kapital potencial në ndërmarrjet që nuk janë të listuara në bursë, përfshirë edhe kapitalin që sigurohet nga investitorë të jashtëm të specializuar;

d) "kapital fillestar" kupton burimin e financimit që nevojitet për studimin, vlerësimin dhe zhvillimin e një koncepti fillestar, duke i paraprirë fazës së themelimit;

e) "kapital i themelimit" kupton burimin e financimit që sigurohet nga ndërmarrjet, të cilat nuk kanë shitur produktet ose shërbimet e tyre në treg dhe ende nuk kanë krijuar një fitim nga zhvillimi dhe marketingu i produktit;

f) "kapital i zgjerimit" kupton burimin e financimit që nevojitet për rritjen dhe zgjerimin e një ndërmarrjeje, e cila mund ose nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e saj fitimprurëse, me qëllim rritjen e kapaciteteve të prodhimit, zhvillimit të tregut/të produkteve ose krijimin e një kapitali qarkullues shtesë;

g) "strategji e daljes" kupton një strategji për likuidimin e aksioneve që zotërohen nga investitorët e jashtëm të specializuar ose nga fondet e kapitalit privat, në përputhje me një plan, i cili synon normën maksimale të kthimit të investimit, duke përfshirë:

- shitjen në treg të aksioneve;
- heqjen nga pasqyra e bilancit të inventarit të dëmtuar;
- ripagesën e aksioneve të preferuara/borxheve;
- shitjen te një investitor tjetër i jashtëm;
- shitjen te një institucion financiar; dhe
- shitjen nëpërmjet një oferte publike (përfshirë oferta publike primare);

h) "ndërmarrja e synuar" kupton një ndërmarrje tek e cila synon të investojë një investitor ose një fond investimi.

5.2 Kushtet për dhënien e ndihmës në formën e riskut të kapitalit

Ndihma duhet të këtë formën e pjesëmarrjes në një fond investimi fitimprurës, i cili menaxhohet, duke u mbështetur në mekanizmat e funksionimit të tregut.

Për SME-të që ndodhen në zonat e thella, sikurse edhe për ndërmarrjet e vogla që ndodhen në zonat e tjera, ndihma nëpërmjet riskut të kapitalit duhet të jetë e kufizuar vetëm në vlerën e nevojshme për sigurimin e burimit të financimit të kapitalit fillestar, kapitalit të themelimit dhe/ose kapitalit të zgjerimit. Për ndërmarrjet e mesme që nuk ndodhen në zonat e thella, ndihma nëpërmjet riskut të kapitalit do të jetë e kufizuar vetëm në vlerën e nevojshme për sigurimin e burimit të financimit të kapitalit fillestar dhe/ose kapitalit të themelimit, duke përjashtuar kapitalin e zgjerimit.

Në mënyrë që të sigurohet se ndihma nëpërmjet riskut të kapitalit është dobiprurëse kërkohet që:

i) të ekzistojë një plan biznesi për çdo investim, i cili duhet të përmbajë të dhëna të hollësishme për

produktet, shitjet dhe rentabilitetin, si dhe të paraqitet vizioni që do ketë projekti; dhe

ii) të ekzistojë një strategji e qartë dhe realiste për çdo investim.

Nga ana tjetër, për t'u siguruar se menaxhimi i fondeve të investimit kryhet mbështetur në mekanizmat e tregut, duhet që:

i) të ekzistojë një marrëveshje mes një menaxheri fondi/një kompanie menaxhimi dhe pjesëmarrësve në fond, duke mundësuar varësinë e shpërblimit të menaxherit nga performanca dhe objektivat e vëna nga fondi. Marrëveshja duhet të parashikojë kohëzgjatjen e investimit; dhe

ii) investitorët në kapitalin privat duhet të përfaqësohen në strukturën e fondit të investimit, si për shembull nga një komitet investitorësh ose këshilltarësh; dhe

iii) në menaxhimin e fondit duhet të aplikohen praktikat më të mira dhe mbikëqyrja.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr.1141, datë 8.12.2006, shpall të zhdukur shtetasin Evangjellos Bineri, i datëlindjes 2.6.1966, me datë zhdukjeje 25.6.2002.

KËRKESË

Shtetësja Helga Kondi, e bija e Xhaferit, e datëlindjes 6.10.1961, banuese në Itali, Via Napoleone, 79/B, c.a.p 25039 Travagliato, Brescia, kërkon shpalljen të vdekur të gjyshes së saj, Seide Kondi e bija e Zejnelit dhe e Shemsies, lindur në vitin 1901.

KËRKUESJA
Helga Kondi

KËRKESË

Shtetësja Lindita Çeliku, e bija e Petit dhe e Elisavetes, e datëlindjes 11.6.1973, lindur e banuese në Tiranë, rruga "H.Cenoimeri", kërkon shpalljen të vdekur të vëllait të saj, Elton Çeliku.

KËRKUESJA
Lindita Çeliku

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA
(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 21.12.2007
Doli nga shtypi më 21.12.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 32 lekë